



www.qbz.gov.al

# Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 21

**Tiranë – E mërkurë, 21 qershor 2023**

## PËRMBAJTJA

|                                                                                   | Faqe                                                                                                                                                                                                                                          |
|-----------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Kërkesë e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 3641/1, datë 9.6.2023             | Për publikimin e kontratës kolektive të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës të Shqipërisë (FSASH) dhe Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë (SPASH)..... 3 |
| Kërkesë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 17, datë 16.6.2023 | Për shprehje interesi për asistent zyre, përfitues i së cilës është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale..... 12                                                                                                                    |



**KËRKESË****Nr. 3641/1, datë 9.6.2023****PËR PUBLIKIMIN E KONTRATËS  
KOLEKTIVE TË NËNSHKRUAR  
NDËRMJET MINISTRISË SË ARSIMIT  
DHE SPORTIT (MAS), FEDERATËS SË  
SINDIKATAVE TË ARSIMIT DHE  
SHKENCËS TË SHQIPËRISË (FSASH)  
DHE SINDIKATËS SË PAVARUR TË  
ARSIMIT TË SHQIPËRISË (SPASH)**

Sot, më datë 9.6.2023, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, nënshkruhet kjo kontratë kolektive pune, ndërmjet:

Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), përfaqësuar nga ministrja znj. Evis Kushi, njëra palë;

dhe

Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës të Shqipërisë (FSASH), përfaqësuar nga kryetari, kryetari z. Isa Reka;

Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë (SPASH), përfaqësuar nga presidenti z. Nevruz Kaptelli;

pala tjetër.

Bazuar në nenet 163 e në vijim, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në fazën përgatitore të fillimit të bisedimeve për negociimin dhe nënshkrimin e kontratës kolektive të punës, palët përfaqësuese të punëmarrësve FSASH dhe SPASH, me anë të depozitimit në MAS të statuteve, vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që i njeh si persona juridikë, treguesit e përfaqësueshmërisë, si dhe kërkesën për fillimin e bisedimeve, provuan identitetin e tyre juridik dhe të përfaqësimit, për të nënshkruar me MAS-in kontratën kolektive të punës.

FSASH dhe SPASH, në kërkesën për fillimin e bisedimeve për nënshkrimin e kontratës kolektive të punës, kanë deklaruar se do të hyjnë në bisedime dhe do ta ushtrojnë këtë të drejtë së bashku, për t’u paraqitur si palë e vetme përpara punëdhënësit.

Bazuar në sa më sipër, pala punëdhënëse, Ministria e Arsimit dhe Sportit, njohu FSASH-në dhe SPASH-in, si sindikatat më përfaqësuese të punëmarrësve në sektorin e arsimit parauniversitar dhe i ftoi ato për të filluar procesin e bisedimeve

për hartimin dhe nënshkrimin e kësaj kontrate kolektive.

Në përfundim palët u dakordësuan të hartojnë kontratën kolektive të punës me përmbajtjen si vijon.

Neni 1

**Baza ligjore**

Kjo kontratë kolektive mbështetet në nenet 50 dhe 51 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në konventat ndërkombëtare të punës, veçanërisht në konventat nr. 87 dhe 98, në kapitullin 26 “Arsimi dhe Kultura” nga kapitujt e *acquis* të negociatave të [Anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian](#) dhe praktikat e mira të OECD-së, në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në kreun XV “Kontrata kolektive e punës” dhe veçanërisht në nenin 181, “Liritë sindikale – parimet”, përfshirë pikën 7, shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, dhe pikën 8, sipas të cilës “Të drejtat sindikale, të përfituara në më shumë se dy kontrata kolektive të njëpasnjëshme, nuk mund të kundërshtohen nga punëdhënësi”; në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës në tërësi dhe ato në fushën e arsimit në veçanti.

Neni 2

**Fusha e zbatimit të kontratës**

2.1 Kjo kontratë kolektive i shtrin efektet e saj mbi të punësuarit në sistemin arsimor parauniversitar publik, të cilët janë në varësi të zyrave vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP), si: mësuesit e klasave përgatitore, mësuesit e arsimit fillor, mësuesit e arsimit të mesëm të ulët, mësuesit e arsimit të mesëm të lartë, drejtuesit e institucioneve arsimore parauniversitare publike.

2.2 Dispozitat e kësaj kontrate kolektive janë të detyrueshme për zbatim për nënshkrimin e kontratave kolektive në nivel vendor për arsimin parashkollor, në shkollë dhe arsimin profesional, në kuptimin që këto subjekte nuk mund të përfshijnë në kontratë më pak të drejta për punëmarrësit se sa legjislacioni shqiptar dhe kjo kontratë kolektive.



## Neni 3

**Kohëzgjatja e kontratës**

3.1 Kjo kontratë kolektive do të zbatohet nga data e nënshkrimit të saj deri më 31 dhjetor 2027.

## Neni 4

**Punësimi**

4.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, të gjithë punonjësit që aktualisht kanë një vend pune në sistemin e arsimit parauniversitar me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar dhe që plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 69/2012 dhe nenin 4 të kësaj kontrate, e ruajnë këtë status, për aq kohë sa ka ngarkesë mësimore në ZVAP-në përkatëse.

4.2 Anëtarë të sindikatave nënshkruese të kësaj kontrate konsiderohen vetëm ata të punësuar që janë deklaruar personalisht me shkrim, në mënyrë vullnetare (sipas formatit të deklaratës personale) dhe që paguajnë kuotizacionin sindikal, sipas mënyrës dhe masës që përcaktohet në statutet e FSASH-së dhe SPASH-it.

4.3 Kriteret për ushtrimin e profesionit për kategoritë e punonjësve të përcaktuar në pikën 2.1 të nenit 2 të kësaj kontrate, janë sipas përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

4.4 Në institucionin arsimor publik, përfshirë dhe atë parashkollor, pranimi dhe emërimi i mësuesit në një vend të lirë pune mbështetet në parimin e meritës dhe të drejtën për zgjedhjen e institucionit arsimor. Emërimi i mësuesit bëhet nga drejtori i institucionit arsimor, sipas renditjes në portalin “Mësues për Shqipërinë”. Procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune si dhe administrimi i portalit “Mësues për Shqipërinë”, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

4.5 Personi që merret në punë për herë të parë pajiset nga punëdhënësi me librezë pune, e cila është unike për të gjithë të punësuarit, sipas modelit të përcaktuar nga organi kompetent.

4.6 Punëdhënësi nuk mund të zgjidhë kontratën e punës pa shkaqe të arsyeshme ose pa shkaqe të justifikuara, duke u mbështetur te nenet 146 dhe 153 të Kodit të Punës. Palët bien dakord që FSASH-ja/SPASH-i për anëtarët e tyre të negociojnë me punëdhënësin për zgjidhjet që ofrojnë dispozitat e pikave 2 dhe 3 të neneve 146 dhe 153 të Kodit të Punës.

4.7 Zgjidhja e marrëdhënieve kontraktuale të punës nga punëdhënësi pa shkaqe të arsyeshme, është e pavlefshme. Në këtë rast, punëdhënësi detyrohet t'i paguajë dëmshpërblim punëmarrësit, sipas dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi.

4.8 Kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, për zgjidhjen e marrëdhënieve kontraktuale të punës, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë ndaj punëmarrësit këto afate njoftimi:

a) një muaj, për të punësuarit që kanë një vit punë;

b) dy muaj, për të punësuarit që kanë dy deri në pesë vjet punë;

c) tre muaj, për të punësuarit që kanë më shumë se 5 vjet punë.

Në mungesë të njoftimit të këtyre afateve, punëdhënësi është i detyruar t'i paguajë punëmarrësit pagën mujore që i korrespondon afatit të njoftimit (neni 143 i Kodit të Punës).

4.9 Punëmarrësi fiton shpërblim për vjetërsinë, kur kontrata është zgjidhur nga punëdhënësi dhe marrëdhëniet e punës midis tyre kanë zgjatur jo më pak se tre vjet. Në këtë rast, zbatohen dispozitat e nenit 145 të Kodit të Punës. Sindikatat nënshkruese të kontratës kolektive mbështesin anëtarët e tyre, që këtë shpërblim ta përfitojnë, duke negociuar me punëdhënësin ose duke e zgjidhur çështjen në rrugë gjyqësore.

4.10 Zgjidhja e menjëhershme e marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi ose punëmarrësi bëhet duke respektuar dispozitat e neneve 153 deri 156 të KP-së.

4.11 Punëdhënësi është i detyruar të ruajë vendin e punës:

a) për prindërit me raport lindjeje;

b) për punonjësit që nuk gëzojnë shëndet të plotë dhe këtë e vërtetojnë me raport mjekësor, për aq kohë sa zgjat paaftësia e përkohshme. Këtë të drejtë e përfitojnë edhe punëmarrësit që marrin leje për kujdes familjar, me ose pa të drejtë page, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

4.12 Në kuptimin e neneve 31, 33 dhe 92 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i punësuar në institucionet e arsimit parauniversitar mund t'i përfundojë marrëdhëniet e punës me kërkesën e tij ose të punëdhënësit, me kusht që të ketë plotësuar kushtet që përmbajnë dispozitat e mësipërme dhe t'i ketë lindur e drejta për pension të plotë pleqërie. Duke pasur në



konsideratë interesin më të lartë të nxënësit, për rastet kur gjatë periudhës mësimore, mësimdhënësi plotëson moshën e daljes në pension, punëdhënësit i ndalohej ndërprerja në mënyrë të njëanshme e marrëdhënieve të punës, deri në përfundim të asaj periudhe mësimore.

#### Neni 5

### Ndryshimi i vendit të punës

5.1 Sindikatat mbështetin kërkesat e anëtarëve të tyre të punësuar në arsim për ndryshimin e vendit të punës, me kusht që të përmirësohet pozita e punëmarrësit. Sindikatat, së bashku me kërkesën e të punësuarit për ndryshimin e vendit të punës, i paraqitin punëdhënësit përkatës edhe mendimin e tyre me shkrim dhe të argumentuar, brenda muajit maj të çdo viti.

5.2 Miratimin ose mosmiratimin e kërkesës së punëmarrësit për ndryshimin e vendit të punës, punëdhënësi është i detyruar t'ia njoftojë punëmarrësit para fillimit të vitit të ri shkollor, duke parashtruar edhe argumentet përkatëse.

5.3 Ndryshimi i vendit të punës me iniciativën e punëdhënësit bëhet vetëm për raste të veçanta dhe konkretisht:

a) për t'u sistemuar në një shkollë tjetër, kur shkurohet vendi i punës në shkollën e mëparshme; kur ka vetëm një konkurrues për vendin e punës, sistemimi i mësuesit në shkollën e re bëhet pa iu nënshtruar procedurave të konkurrimit;

b) kur ndryshimi i vendit të punës bëhet për shkak që përcaktohen në shkronjën “a” të këtij neni, transferimi nuk duhet të ndikojë në keqësimin e shëndetit të punëmarrësit, as në përkeqësimin e kushteve ekonomike, financiare dhe të jetesës;

c) për gratë me fëmijë nën moshën tre vjeç, ndryshimi i vendit të punës nuk bëhet kur rruga vajtje-ardhje zgjat më shumë se 30 minuta më këmbë, me përjashtim të rasteve kur transferimi bëhet me kërkesën e punëmarrëses ose është në favor të saj.

5.4 Në rastet e ndryshimit të vendit të punës për mësuesit sindikalistë, anëtarë të FSASH-së/SPASH-it, me kërkesën e këtyre të fundit, punëdhënësi është i detyruar t'i vërë në dijeni ata për motivet e ndryshimit të vendit të punës dhe për pasojat juridike, ekonomike dhe sociale që vijnë në këtë rast.

5.5 Kur ka kundërshtime nga sindikata ose i interesuari, brenda 30 ditëve nga marrja e këtij njoftimi, palët duhet të bëjnë konsultime dhe të gjejnë zgjidhjet ligjore, në të kundërt, secila palë rezervon të drejtën t'i drejtohet Zyrës së Pajtitimit ose Gjykatës, vendimet e së cilës janë të detyrueshme për palët.

#### Neni 6

### Koha e punës

6.1 Në arsimin parauniversitar zbatohet java 5-ditëshe e punës, nga e hëna deri të premten. Për nevoja të procesit mësimor-edukativ dhe të aktiviteteve jashtëshkollore, përjashtimet bëhen me marrëveshje të veçantë midis punëdhënësit dhe punëmarrësit në nivelin e njësisë arsimore vendore ose të institucionit arsimor dhe seksioneve sindikale vendore.

6.2 Në arsimin bazë dhe në arsimin e mesëm të lartë, koha javore e punës përbëhet nga:

a) nga koha ditore gjatë së cilës punëmarrësi është në dispozicion të punëdhënësit. Në zbatim të kësaj kërkesë, palët konfirmojnë se mësuesit e punësuar në arsimin bazë dhe në arsimin e mesëm paraqiten në shkollë 20 minuta para fillimit të mësimit dhe qëndrojnë në ambientet e shkollës derisa mbaron programi mësimor i turnit përkatës, por jo më shumë se 6 orë 60-minutëshe në ditë.

b) normat e punës mësimore javore përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin, në konsultim me sindikatat nënshkruese të kontratës kolektive të punës dhe konsiderohen si pjesë e kësaj kontrate.

Përjashtimet bëhen me marrëveshje të posaçme midis MAS-it dhe FSASH-së/SPASH-it. Punëdhënësi në nivelin e institucionit arsimor është i detyruar që të krijojë kushte të përshtatshme për mësuesit, për t'iu mundësuar atyre që kohën e qëndrimit në institucion (shkollë) ta shfrytëzojnë në mënyrë aktive dhe në ambiente të përshtatshme.

6.3 MAS-i merr përsipër që nëpërmjet konsultimeve me FSASH-në/SPASH-in të bjerë dakord për nxjerrjen e akteve normative, të cilat të adresojnë në mënyrë të qëndrueshme dhe afatgjatë problemin e ngarkesës mësimore javore në kushtet e uljes së përgjithshme të numrit të nxënësve, veçanërisht në zonat rurale. Në zgjidhjen e këtij problemi, parimet bazë të jenë garantimi i së drejtës për arsimim të çdo fëmije, rritjes së cilësisë së



mësimdhënies dhe garantimit të vendeve të punës të personelit të përhershëm mësimdhënës dhe respektimit të standardeve të shkollës qendër komunitare.

6.4 Mësuesit që punojnë në ciklin e ulët dhe mësuesit që kanë klasë në kujdestari, u barasvlerësohet kjo punë me dy orë mësimore.

6.5 Orët mësimore që mësuesi zhvillon mbi normën e caktuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin, paguhen si orë suplementare.

6.6 Mësimdhënësit gëzojnë të drejtën për orë mësimore suplementare të pagueshme deri në 30% të ngarkesës mësimore.

6.7 Koha e punës (qëndrimit në punë) dhe ngarkesa mësimore e mësuesve të cilësuar “invalidë pune” do të jetë në përputhje me vendimin e KMCAP-së.

6.8 Mësuesit e cilësuar “invalidë pune” nuk mund të ngarkohen me orë mësimore mbi normë.

6.9 Orët shtesë mbi normë për veprimtaritë mësimore-edukative në ditët e pushimit javor për realizimin e programit ose të aktiviteteve zyrtare që bëjnë njësitë arsimore vendore, do të paguhen sipas nenit 91, pika 3 e Kodit të Punës.

6.10 Normat e punës mësimore edukative, përfshirë normat e veçanta dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar, janë sipas përcaktimit të bërë në udhëzimet përkatëse të ministrit përgjegjës për arsimin.

#### Neni 7

##### Kushtet e punës

7.1 Institucioni arsimor duhet t'u krijojë mësuesve kushte dhe mundësi për punë krijuese dhe të pavarur në procesin e mësimdhënies, përfshirë:

a) lirinë profesionale në zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulës;

b) sigurimin e kushteve të mjaftueshme për mësimdhënie efektive;

c) krijimin e mundësive për zhvillim profesional dhe punë kërkuese.

7.2 MAS-i dhe sindikatat nënshkruese të kësaj kontrate, marrin përsipër që në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore të krijojnë në të gjitha institucionet e arsimit publik, kushte pune bashkëkohore për mësuesit dhe nxënësit.

Në këto kushte përfshihen ruajtja, mirëmbajtja, ngrohja e objekteve shkollore, kushte të përshtatshme higjieno-sanitare në kopshte dhe në shkolla, përfshirë mjetet e nevojshme për të siguruar higjienën vetjake, ujë në sasi të mjaftueshme, dhoma higjienike për gratë, tualete sipas standardeve dhe në numër të mjaftueshëm, si dhe krijimin e hapësirave të nevojshme që t'u mundësojnë mësuesve kushte normale për punë dhe studim gjatë orëve të qëndrimit në institucion.

7.3 Punëdhënësi merr masat e duhura për dhënien e ndihmës së shpejtë, siç përcaktohet në nenin 75 të Kodit të Punës.

7.4 MAS-i dhe FSASH-ja/SPASH-i do të negociojnë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për të mundësuar që të gjithë mësuesit, të përfitojnë falas ekzaminimin që kërkohet me udhëzimin e përbashkët nr. 2, datë 25.6.2004, të dy dikastereve të cituara.

#### Neni 8

##### Koha e pushimit

8.1 Koha e pushimit në sistemin e arsimit publik përbëhet nga pushimet javore dhe pushimet vjetore.

8.2 Pushim javor janë dita e shtunë dhe e diel.

8.3 Përcaktimi i kohës së pushimeve vjetore të pagueshme, mbështetet në pikën 2, të nenin 92, dhe në pikën 8 të nenit 181 të Kodit të Punës. Bazuar në këto nene pushimet vjetore për mësimdhënësit dhe drejtuesit e institucioneve arsimore përbëhen nga 56 ditë pune, ku përveç pushimeve verore, përfshihen edhe ditët kur mësimi ndërpritet sipas programit mësimor vjetor.

- Për periudhën e verës koha e pushimit nuk mund të jetë më pak se 45 ditë kalendarike dhe nuk mund të ndërpritet më shumë se një herë.

- Pushimi vjetor për personelin ndihmës dhe personelin e shërbimeve është jo më pak se 4 javë kalendarike.

8.4 Për efekt të lejes vjetore, në kohën e punës llogaritet edhe koha e paafësisë së përkohshme në punë.

8.5 Punëmarrësit anëtarë të sindikatave nënshkruese të kësaj Kontrate, në rast martese ose vdekjeje të bashkëshortit, të paraardhësve ose pasardhësve të tyre të drejtpërdrejtë, të motrave



dhe vëllezërve, përfitojnë një pushim të paguar prej 5 ditësh.

8.6 Në rast sëmundjeje të rëndë të paraardhësve ose pasardhësve të drejtpërdrejtë, të vërtetuar me raport mjekësor, punonjësit e arsimit, anëtarë të sindikatave nënshkruese të kësaj Kontrate, përfitojnë deri në 10 ditë pune të papagueshme në muaj ose 120 ditë në vit.

#### Neni 9

### **Zhvillimi i vazhdueshëm profesional dhe kualifikimi i mësuesve**

9.1 Institucioni arsimor planifikon zhvillimin profesional të mësuesve, sipas nevojave të tyre dhe në përputhje me politikat arsimore qendrore, vendore dhe të institucionit, përfshirë zhvillimin e brendshëm profesional, trajnimet, rrjetet profesionale, këshillimet dhe kurset afatshkurtra dhe afatgjata. Zhvillimi i brendshëm profesional bëhet në nivel shkolle nëpërmjet këshillit të mësuesve dhe ekipeve lëndore.

9.2 Punëdhënësi merr përsipër trajnimin profesional të mësuesve sipas nenit 58, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për jo më pak se 3 ditë në vit.

9.3 Punonjësit arsimorë të institucioneve, që kanë nxënës me aftësi të kufizuara, certifikohen në programe trajnimi për trajtimin e këtyre nxënësve.

#### Neni 10

### **Sistemi i pagave dhe i shpërblimeve**

10.1 Mbështetur në Strategjinë e Sistemit Arsimor Parauniversitar dhe në programet e MAS-it dhe të Qeverisë, që konsiderojnë arsimin sektor prioritar, të dyja palët bien dakord që të punojnë së bashku për të ndërtuar e zbatuar, nga viti në vit, një sistem pagash dhe shpërblimesh që mundëson një vlerësim më të mirë të figurës dhe të punës së mësuesit dhe një motivim më të madh të tyre, të bazuar në angazhimin në procesin e reformimit e modernizimit të arsimit dhe të cilësisë së mësimdhënies.

10.2 Palët bien dakord që, në bazë të dispozitave të Kodit të Punës, të Kartës së Lirive dhe të Drejtave të Njeriut dhe të Kartës Sociale Evropiane, të garantojnë për të punësuarit në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar publik pagë

të barabartë për punë të barabartë dhe profesion të njëjtë, pa asnjë dallim.

10.3 Pagat e punonjësve mësimorë dhe ndihmës në sistemin e arsimit parauniversitar janë sipas strukturës së pagave të miratuara në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave në fuqi.

10.4 Pala punëdhënëse konfirmon se, bazuar në nenin 1 të ligjit nr. 8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, i ndryshuar, në kuadrin e partneritetit social, në procesin e hartimit të buxhetit të çdo viti do të konsultohet dhe do të marrë mendimin e sindikatave nënshkruese të kontratës kolektive, përpara se propozimet përkatëse të dërgohen në Qeveri.

Në mënyrë të posaçme, MAS-i do të zhvillojë çdo vit konsultime me FSASH-në/SPASH-in për masën e rritjes së pagave, për ndërtimin e raporteve më të drejta midis pagës minimale dhe maksimale në sistemin publik të arsimit parauniversitar, të komponentit të pagës që ka të bëjë me përgatitjen dhe aftësimin profesional të mësuesve, si dhe me ndërtimin e një sistemi që inkurajon dhe motivon mësuesit që dallohen për rezultate më të mira në objektivin e arsimit cilësor, zgjidhje këto që vendosen e përballohen brenda kuotave të buxhetit të shtetit të aprovuar për këtë nivel arsimit.

10.5 Pala punëdhënëse pranon kërkesën e sindikatave që rritja vjetore e pagës për punonjësit e sistemit arsimor parauniversitar të negociohet çdo vit buxhetor.

10.6 Në bazë të nenit 21 të Kartës Sociale Evropiane për të Drejtën e Partnerëve Socialë për Informim dhe me qëllim që të luftohen me efikasitet shpërdorimet dhe korrupsioni në menaxhimin e buxhetit të arsimit, sidomos për pagat, shpërblimet, shpenzimet operative dhe investimet, punëdhënësi është i detyruar që të njohë përfaqësuesit kryesorë të sindikatave qendrore me të gjitha të dhënat përkatëse financiare, të burimeve njerëzore etj. Ky detyrim qëndron edhe për partnerët në nivelin vendor.

10.7 Kur mësuesit kryejnë orë mësimi mbi ngarkesën mësimore vjetore të përcaktuar me udhëzim të ministrit, orët suplementare u paguhen sipas dispozitave përkatëse të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

10.8 Punonjësit e përcaktuar në pikën 2.1, të kreut 2, të kësaj kontrate, të cilët punojnë larg vendbanimit të tyre në distancën mbi 5 km dhe



kthehen brenda ditës në vendbanimin e përhershëm, përfitojnë një shtesë mbi pagë dhe shpenzimet e udhëtimit vajtje-ardhje, sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.

10.9 Me autorizim me shkrim nga sindikatat nënshkruese të kësaj kontrate kolektive, mësuesit anëtarë të FSASH-së/SPASH-it, që dalin në pension, përfitojnë një deri në dy paga mujore neto shpërblim.

10.10 Punëdhënësi, bazuar në marrëveshjen e datës 28 janar 1999 nga Qeveria Shqiptare dhe FSASH-ja, iu njehtë drejtën e fituar sindikatave nënshkruese për shpërblim vjetor të mësuesve në sistemin e arsimit publik parauniversitar. Masa e shpërblimit caktohet me marrëveshje midis palëve.

#### Neni 11

##### **Mbështetja e strategjisë, reformimit dhe modernizimit të arsimit**

11.1 Sindikatat nënshkruese të kësaj kontrate kolektive, konfirmojnë se arsimit cilësor publik dhe jopublik dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës do të jenë prioritet i punës së tyre, se mbështetja dhe përfshihen aktivisht në procesin e hartimit dhe të zbatimit të Reformës së Sistemit Arsimor Parauniversitar, për reformimin dhe modernizimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, se vlerësojnë programin e Qeverisë që e konsideron arsimin si sektor prioritar, dhe ofrojnë bashkëpunimin e tyre për përdorimin me efektivitet, kundër çdo abuzimi, shpërdorimi apo korrupsioni në dëm të buxhetit të shtetit.

11.2 Nëpërmjet seminareve, tryezave, diskutimeve në këshillat sindikale e forumet sindikale, sindikatat do të zbërthejnë aspekte të veçanta të Reformës së Sistemit Arsimor Parauniversitar, përfshirë arsimin cilësor, krijimin e shanseve të barabarta për të gjithë nxënësit, procesin e vlerësimit, të motivimit, tekstet etj., duke e vënë theksin në njohjen dhe zbatimin e këtyre kërkesave nga mësuesit dhe anëtarët e sindikatave.

11.3 Sindikatat partnere bien dakord që të bashkërendojnë veprimtarinë e tyre me punëdhënësin dhe me aktorë të tjerë të interesuar për arritjen e këtyre qëllimeve.

#### Neni 12

##### **Angazhimi i përbashkët për uljen e numrit të fëmijëve që braktisin shkollën dhe eliminimin e punës së fëmijëve**

12.1 Të dyja sindikatat e arsimit, FSASH-ja e SPASH-i, angazhohen që, me mundësitë e tyre dhe me mbështetje të tjera, sidomos nga Federata Ndërkombëtare e Arsimit, EI, nga sindikatat homologe etj., të bëjnë një punë të veçantë për uljen e numrit të nxënësve që braktisin shkollën dhe eliminimin e punës së fëmijëve.

12.2 Nëpërmjet trajnimeve të drejtuesve sindikalë dhe të anëtarëve të sindikatave, si dhe nëpërmjet formave të tjera të punës konkrete në shkolla e në komunitet, ato do të synojnë për rritjen e numrit të mësuesve të angazhuar në një punë të veçantë me nxënësit që braktisin shkollën ose që janë në rrezik për ta braktisur atë, duke krijuar për ta një mjedis më tërheqës dhe më prindëror dhe duke pasur si objektiv eliminimin e punës së fëmijëve.

12.3 Ministria e Arsimit dhe Sportit, duke e pasur si një ndër prioritetet e strategjisë së saj, mbështet këtë angazhim dhe siguron gatishmërinë e institucioneve arsimore për veprime të përbashkëta, duke nxitur edhe përfshirjen e organizmave të nxënësve dhe prindërve që veprojnë në shkolla.

12.4 Me propozimin e kryesive të sindikatave nënshkruese të kontratës kolektive, njësitë arsimore vendore shpërblejnë mësuesit që janë të angazhuar drejtpërdrejt dhe kanë rezultate të matshme për uljen e numrit të nxënësve që braktisin shkollën dhe eliminimin e punës së fëmijëve.

#### Neni 13

##### **Liritë dhe të drejtat sindikale**

13.1 Ministria e Arsimit dhe Sportit tërheq vazhdimisht mendimin e sindikatave nënshkruese të kësaj kontrate kolektive në procesin e hartimit të akteve ligjore e nënligjore që lidhen me reformën në arsim, me marrëdhëniet e punës, pagat, shpërblimet, kushtet e punës etj.

13.2 Sindikatat nënshkruese të kësaj kontrate kolektive pajisen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit me urdhrat, udhëzimet dhe aktet e tjera të nxjerra prej saj.



13.3 Për të garantuar të zgjedhurit në pozicionet drejtuese sindikale për kryerjen e detyrës së tyre, ku përfshihen kryetari, nënkryetari dhe sekretari i Këshillit Sindikal Vendor, si dhe kryetarët e këshillave sindikale në shkolla, punëdhënësit i ndalohej t'i largojë ata nga puna ose t'ua ndryshojë vendin e punës, pa marrë më parë pëlqimin me shkrim të kryesisë së SPASH-it/FSASH-së, përveç rasteve kur vërehen shkelje të ligjit ose të kontratës kolektive të punës.

13.4 Drejtuesve të seksioneve sindikale në njësitë arsimore vendore të secilës sindikatë nënshkruese të kontratës kolektive, për t'u mundësuar marrjen me veprimtari sindikale, mbështetur në nenin 181, pika 7 e Kodit të Punës, u reduktohet ngarkesa mësimore javore nga 5 deri në 10 orë në javë, si rregull, sipas numrit të anëtarësisë me kuotizacion.

Seksioneve sindikale që kanë më shumë se 600 anëtarë, u reduktohet norma mësimore javore edhe me 6–8 orë në javë edhe një përfaqësuesi tjetër të FSASH-së/SPASH-it.

Normë mësimore të reduktuar përfitojnë edhe kryetarja e komisionit të gruas dhe kryetarja/kryetari i komisionit të rinisë në nivel kombëtar nga 6–8 orë në javë.

Masa konkrete e reduktimit të normës mësimore javore për çdo drejtues seksioni, vendoset nga secila sindikatë qendrore dhe u njoftohet njësitë arsimore vendore para fillimit të çdo viti mësimor.

Titullarët e sindikatave qendrore përgjigjen për zbatimin me korrektësi të kësaj dispozite dhe për shfrytëzimin me efektivitet të kohës së punës që u është vënë në dispozicion drejtuesve sindikalistë vendorë. Ata mund të anulojnë në çdo kohë autorizimin e tyre për uljen e ngarkesës mësimore për ata drejtues sindikalë vendorë që nuk e justifikojnë këtë lehtësi që u bëhet.

13.5 Me kërkesën e FSASH-së/SPASH-it, të zgjedhurve në kryesitë e sindikatave në njësitë arsimore vendore dhe këshilli sindikal në nivel shkolle, u sigurohet leje e pagueshme për të marrë pjesë në veprimtaritë sindikale lokale, kombëtare e ndërkombëtare. Kërkesa i paraqitet punëdhënësit përkatës nga kryesitë e seksioneve sindikale vendore, të paktën 3 ditë para aktivitetit.

13.6 Me kërkesën e kryesive të FSASH-së/SPASH-it, ZVAP-së Tiranë dhe një ZVAP-je tjetër të përcaktuar nga FSASH-ja/SPASH-i vë në

dispozicion të tyre, për t'u marrë me veprimtari sindikale, nga 1 (një) mësues për secilën sindikatë me ngarkesë mësimore javore të reduktuar, duke i ngarkuar këta mësues me jo më shumë se 10 orë mësimi në javë.

13.7 Në pajtim me nenin 181, pika 6, e Kodit të Punës, të zgjedhurit në organet sindikale në qendër e në njësitë arsimore vendore, me mbarimin e mandatit, kanë të drejtë për t'u rikthyer në punë në vendin dhe profilin e tyre.

13.8 Sindikatat nënshkruese të kësaj kontrate kolektive, me kërkesën e tyre, duhet të njihen me të gjithë treguesit ekonomik-financiar në nivel qendror dhe lokal.

13.9 Dita e Mësuesit (7 Marsi) dhe Dita Ndërkombëtare e Mësuesve (5 Tetori), do të jenë në të gjithë vendin ditë veprimtarish kushtuar këtyre festave.

13.10 Veprimtaritë sindikale zhvillohen në mjediset e shkollës, pa dëmtuar procesin mësimor. Seksionet dhe Këshillat Sindikale kanë të drejtë të shpërndajnë dhe të publikojnë në mjediset e institucionit arsimor, njoftime, programe, objektiva, përfshirë kontratën kolektive dhe dokumente të tjera të tyre.

13.11 Punëdhënësi në nivel institucioni arsimor vë në dispozicion të punëmarrësit një kopje të Kodit të Punës dhe një kopje të kontratës kolektive të punës.

13.12 Kryetarëve të këshillave sindikale në shkolla, që përfaqësojnë më shumë se 15 anëtarë, nuk u caktohet klasë në kujdestari.

13.13 Ministria e Arsimit dhe Sportit u siguron dy sindikatave qendrore, mjedise pune dhe pajisje për zhvillimin normal të veprimtarisë së tyre, ndërsa njësitë arsimore vendore duhet t'u sigurojnë ambiente dhe pajisje pune seksioneve sindikale të FSASH-së dhe SPASH-it.

13.14 Për të lehtësuar pjesëmarrjen e kryetarëve të seksioneve sindikale të ZVAP-ve në mbledhjet e këshillave drejtuese qendrore të tyre, për 4 (katër) mbledhje në vit, njësitë arsimore vendore, mbulojnë shpenzimet e udhëtimit dhe dietat, mbi bazën e vërtetimeve me shkrim të lëshuara nga kryesitë e sindikatave qendrore, të miratuara nga nëpunësi autorizues i ministrisë përgjegjëse për arsimin.

13.15 Punëdhënësi, bazuar në nenin 117/2 të Kodit të Punës, vetëm me autorizim me shkrim, nëpërmjet Deklaratës Personale të Anëtarësisë, që



përbën edhe autorizimin personal të çdo anëtarë të sindikatave nënshkruese të kontratës kolektive, zbritet çdo muaj nga listëpagesat, kuotizacionin sindikal, të cilin e xhiron në llogaritë përkatëse të secilës sindikatë ku është i anëtarësuar punëmarrësi.

Autorizimi/deklarata personale e anëtarësisë, për zbritjen e kuotizacionit sindikal mund të shfuqizohet në çdo kohë nga punëmarrësi me njoftim me shkrim në sindikatën përkatëse dhe te punëdhënësi. Sindikatat njoftojnë me shkrim, në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate, njësitë arsimore vendore për shumën fikse mujore të kuotizacionit sindikal për anëtarët e tyre, si dhe numrin e llogarisë bankare përkatëse ku do të bëhet xhirimi. Ky njoftim bëhet sa herë që ka ndryshime të masës së kuotizacionit.

Zbritja nga paga e kuotizacionit sindikal, sipas nenit 117, pika 2, të Kodit të Punës, mund të bëhet edhe për sindikata të tjera në arsimin publik parauniversitar, të cilat plotësojnë kërkesat e nenit 163, pika 3, e Kodit të Punës, si dhe kërkesat e neneve 13.15 dhe 14.4 të kësaj kontrate.

#### Neni 14

##### **Zbatimi i kontratës kolektive në nivelin vendor**

14.1 Për arsimin parashkollor lidhen kontrata kolektive midis titullarëve të njërive të vetëqeverisjes vendore dhe seksioneve sindikale vendore.

14.2 Dispozitat e kësaj kontrate kolektive janë të detyrueshme për njësitë arsimore vendore dhe institucionet arsimore në sektorin e arsimit parauniversitar.

14.3 Titullarët e njërive arsimore vendore dhe kryesitë e seksioneve sindikale të FSASH-së/SPASH-it, në kuadër të partneritetit social, zhvillojnë midis tyre takime periodike mbi problematika që lidhet me ecurinë normale të procesit mësimor, më cilësinë e mësimdhënies, me zbatimin e dispozitave të kontratës kolektive, veçanërisht zbatimin e të drejtave sindikale, mbrojtjen social-ekonomike të sindikalistëve, transportit, kushtet e punës dhe të pushimit etj.

14.4 Njësitë arsimore vendore dhe seksionet sindikale të FSASH-së/SPASH-it duhet të formalizojnë dokumentacionin që pasqyron marrëdhëniet midis tyre. Për këtë:

a) Seksionet Sindikale të FSASH-së/SPASH-it depozitojnë në njësitë arsimore vendore

dokumentacionin që vërteton anëtarësinë sindikale, deklaratat personale të anëtarësisë:

- anëtarësia sindikale me lista kolektive është e papranueshme;

- deklaratat personale të anëtarësisë sindikale të çdo mësuesi janë të përhershme, derisa i interesuari nuk e ka tërhequr anëtarësimin me kërkesë me shkrim;

- për vërtetësinë e deklaratave personale të anëtarësisë sindikale, kryetarët e seksioneve sindikale mbajnë përgjegjësi ligjore;

- punëdhënësit i ndalohet me ligj ndërhyrja në procesin dhe procedurat e anëtarësisë sindikale.

b) Dokumentacioni i anëtarësisë sindikale ruhet në arkivin e çdo njësie arsimore vendore. Mbi bazën e tij bazohet njohja nga punëdhënësi e përfaqësueshmërisë sindikale, si dhe kryhen veprimet nga sektorët e financës të njërive arsimore vendore për zbritjen e kuotizacionit sindikal dhe xhirimin e tij në mënyrë periodike në favor të FSASH-së/SPASH-it.

14.5 DPAP-ja, DRAP-i dhe ZVAP-ja ftojnë drejtuesit e FSASH-së/SPASH-it në takimet me drejtuesit e DRAP-së, ZVAP-së dhe ata të institucioneve arsimore, për analizat periodike dhe vjetore të punës.

#### Neni 15

##### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

15.1 Palët bien dakord që kur kontrata kolektive nuk zbatohet ose shkelet nga njëra palë, do të bëhen përpjekje të përbashkëta që mosmarrëveshja të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet rrugës së bisedimeve dypalëshe. Nëse kjo nuk arrihet, pala e dëmtuar i drejtohet Gjykatës, duke kërkuar zbatimin e pikave 2, 3 dhe 4 të nenit 170 të ligjit nr. 7971, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe dëmin e shkaktuar.

15.2 Për rastet kur vërtetohen shkelje të dispozitave të kësaj kontrate, keqinterpretim apo keqzbatim në dëm të një apo disa sindikalistëve, pala punëmarrëse do të ndjekë procedurën e mëposhtme për zgjidhjen e tyre:

a) të punësuarit që kanë ankesa lidhur me shkeljen e të drejtave të tyre të garantuara nga kontrata kolektive dhe legjislacioni i marrëdhënieve të punës, fillimisht, nëpërmjet sindikatës ku bëjnë



pjesë, duhet ta diskutojnë çështjen me punëdhënësin e institucionit arsimor;

b) nëse ankesa nuk zgjidhet me mirëkuptim sipas pikës 1 të këtij neni, i interesuari ose sindikata i drejtohet me shkrim titullarit të njësisë arsimore në territorin e së cilës ka lindur ankesa;

c) në parashtrimin e ankesës duhet të përfshihen: emri i të punësuarit, paraqitja e fakteve, përcaktimi i nenit të shkelur në kontratë me referencat përkatëse, si edhe shkeljet e akteve ligjore ose nënligjore;

d) njësia arsimore vendore, brenda 15 ditëve shqyrton ankesën dhe komunikon vendimin me shkrim për ankuesin;

e) ankuesi, brenda një afati 30-ditor mund ta apelojë vendimin e titullarit të njësisë arsimore vendore në MAS;

f) nëse pas kësaj procedure, konflikti nuk gjen zgjidhje, pala e interesuar, me mbështetjen e sindikatës, i drejtohet Gjykatës.

#### Neni 16

##### Detyrimet dhe sanksionet

16.1 Palët kontraktuese janë të detyruara të përmbushin dhe respektojnë detyrimet që lindin nga Kontrata, duke respektuar kërkesat dhe duke zbatuar zgjidhjet që përmbajnë nenet 169 deri 172 të Kodit të Punës.

16.2 Pala që shkel dispozitat e kësaj kontrate në nivelin qendror ose vendor duke i shkaktuar dëm material ose moral palës tjetër, detyrohet të zhdëmtojë palën e dëmtuar, sipas përcaktimeve që bëhen në pikën 1–7 të nenit 202, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

16.3 Në rast të thyerjes së disiplinës në punë, dëmtimit të rëndë ose të përsëritur të pasurisë së institucionit, punëmarrësve u jepen këto masa disiplinore me shkrim dhe të përshkallëzuara, duke respektuar parimin e proporcionalitetit:

a) qortim;

b) vërejtje;

c) paralajmërim për largim nga puna;

d) dëmshpërblim i dëmit, në masën që vendosin palët nënshkruese të kësaj Kontrate ose Gjykata;

e) largim nga puna.

16.4 Në rast të shkeljeve të rënda të legjislacionit në fuqi, që prishin marrëdhënien e mirëbesimit, dhe e bëjnë të pamundur vijimësinë e marrëdhënies

së punës nga ana e punëdhënësit, mund të bëhet zgjidhja e menjëhershme e kontratës individuale të punës, bazuar në nenin 153 të Kodit të Punës.

#### Neni 17

##### E drejta e aksionit sindikal dhe e grevës

17.1 Për arritjen e qëllimeve të tyre që janë mbrojtja e interesave dhe kërkesave sociale-ekonomike të anëtarëve që përfaqësojnë, sidomos për probleme që lidhen me pagat, shpërblimet, kualifikimin e punonjësve etj., në mbrojtje të zhvillimit të reformës dhe modernizimit të arsimit, të rritjes së cilësisë së procesit mësimor, sindikatat nënshkruese të kontratës kolektive, si partnere të ligjshme të punëdhënësit, MAS-it dhe Qeverisë, do të përdorin, në radhë të parë, negociimin dhe dialogun social, do të bëjnë argumentimin social e ligjor të kërkesave të tyre.

17.2 Nëse rrugët dhe mjetet sindikale që përshkruhen në pikën 1 të këtij neni nuk do të japin rezultat, në kuptimin që nuk do të çojnë në zgjidhjen e kërkesave të parashtruara, në bazë të nenit 50, pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që garanton të drejtën e grevës dhe në bazë të neneve 197, 197/1, 197/2, 197/3, 197/4, 197/8, 197/9 dhe 197/10, të Kodit të Punës, të dyja Sindikatat Qendrore nënshkruese të kontratës kolektive kanë të drejtë të përshkallëzojnë lëvizjen sindikale me anë të protestave, manifestimeve deri te greva e pjesshme ose e përgjithshme.

#### Neni 18

##### Dispozita të fundit

18.1 Palët, me pëlqim të dyanshëm, mund t'i bëjnë plotësime dhe ndryshime kësaj kontrate kolektive gjatë periudhës që ajo është në fuqi, në përputhje me ndryshimet që mund të ndodhin në legjislacionin e vendit ose ndryshime të tjera strukturore, në zbatim të procesit të reformimit e modernizimit të arsimit.

18.2 Bazuar në nenin 175, pika 2, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, MAS-i dhe FSASH-ja/SPASH-i dakordësohen që marrëdhëniet kontraktuale midis tyre edhe mbas përfundimit të afatit të kësaj kontrate kolektive vazhdojnë të rregullohen nga dispozitat e kësaj të fundit deri në nënshkrimin e kontratës së re kolektive.



18.3 Kjo kontratë kolektive mund të zgjidhet nga secila palë vetëm mbas kalimit të afatit të përcaktuar në nenin 3 të saj, si dhe duke respektuar procedurat që përcaktohen në dispozitat përkatëse të Kodit të Punës.

18.4 Dispozitat e kësaj kontrate kolektive janë të detyrueshme për të gjithë punëdhënësit dhe punëmarrësit në nivelin vendor: njësitë arsimore vendore, institucionet arsimore dhe bashkitë. Çdo kontratë kolektive në nivelin vendor apo kontratë individuale, që bie në kundërshtim me dispozitat e kësaj Kontrate është e pavlefshme.

Neni 19  
**Depozitimi**

Kontrata kolektive e punës hartohet në katër kopje të barasvlershme, nga të cilat një depozitohet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, një në Ministrinë përgjegjëse për marrëdhëniet e punës dhe nga një kopje në secilën sindikatë nënshkruese.

PËR MINISTRINË E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
**Evis Kushi**  
MINISTËR

PËR FEDERATËN E SINDIKATAVE TË  
ARSIMIT DHE SHKENCËS  
**Isa Rekaj**  
KRYETAR

PËR SINDIKATËN E PAVARUR TË  
ARSIMIT TË SHQIPËRISË  
**Nevrus Kaptelli**  
PRESIDENT

## KËRKESË

Nr. 17, datë 16.6.2023

### PËR SHPREHJE INTERESI PËR ASISTENT ZYRE, PËRFITUES I SË CILËS ËSHTË MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

**Konsulent individual**

Tiranë, 19 qershor 2023

**Financimi Shtesë i Projektit të Përmirësimit  
të Sistemit Shëndetësor Shqiptar (HSIP)**

**Nr. hua: 93060**

**Numri ID i Projektit: P144688**

**Titulli i detyrës: Asistent zyre**

**Referenca nr. AL-MH-330929-CS-INDV**

Qeveria e Shqipërisë ka marrë financim shtesë në vlerën 25 milionë euro për Projektin e Përmirësimit të Sistemit Shëndetësor në Shqipëri, një hua të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për të shkallëzuar aktivitetet e projektit mëmë dhe për të siguruar direkt ndikimin te përfituesit dhe përmirësimin e mëtejshëm të ofrimit të shërbimit të kujdesit spitalor në vend. Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim ("Banka Botërore") vepron si administrator i shumës së dhënë. Ministria e Shëndetësisë (MSHMS), më poshtë referuar si "Klienti", ka përgjegjësinë e përgjithshme për Projektin dhe Koordinimi i Projektit është përgjegjës për zbatimin e Projektit nëpërmjet Ekipit të tij të Menaxhimit të Projektit (PMT). Objektivi i projektit është të kontribuojë në modernizimin e shërbimeve të përzgjedhura spitalore publike dhe të mbështesë rindërtimin e objekteve të përzgjedhura mjekësore të dëmtuara nga tërmeti i vitit 2019. Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1: Përmirësimi i menaxhimit dhe infrastrukturës së spitaleve

Pjesa 2: Përmirësimi i menaxhimit të informacionit shëndetësor/*e-Shëndetësisë* për shërbimet spitalore

Pjesa 3: Monitorimi, vlerësimi dhe menaxhimi i projektit

Financimi shtesë do të mbështesë më tej reformën spitalore që rrjedh nga masterplani i



spitaleve si një parakusht për racionalizimin e nivelit dytësor të kujdesit shëndetësor në Shqipëri dhe përmirësimin e mëtejshëm të efikasitetit dhe përmirësimit të cilësisë së spitaleve. Sipas komponentit 3 të projektit HSIP, MSHMS-ja do të punësojë një asistent zyre që do të ofrojë mbështetje administrative dhe logjistike, të ndihmojë në koordinimin e rrjedhës së informacionit dhe të gjerë orarin e dhënies së detyrave të ekipit të projektit.

**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kërkon një konsulent individual për të kryer këtë detyrë që plotëson kriteret e mëposhtme:**

- Diplomë *Bachelor* në ekonomi (financë, ekonomi, kontabilitet);
- Përvojë pune 3 vjet, mundësisht në projekte të mbështetura nga donatorët;
- Aftësi të shkëlqyera kompjuterike dhe njohuri të paketës MS Office (kryesisht *Word*, *Excel*, *PowerPoint*) dhe platformat e shkëmbimit të dokumenteve *online*;
- Aftësi të dëshmuara komunikuese dhe organizative;
- Aftësi për të punuar në një ekip, për të trajtuar njëkohësisht detyra të shumta komplekse, për t'u dhënë përparësi detyrave dhe për të përmbushur afate të ngushta;
- Njohja shumë e mirë e gjuhës shqipe dhe angleze (në të folur dhe të shkruar) është thelbësore.

Konsulenti i cili do të zgjidhet (pas përmbushjes së kërkesave minimale të kualifikimit/përvojës më sipër) si më i renditur në bazë të kriterëve të vlerësimit/listës së shkurtër më poshtë, do të ftohet për negociata për kontratën.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përmes Njesisë së Koordinimit të Projekteve (NJKP) tani fton konsulentët lokalë të kualifikuar (“Konsulentët”) që të tregojnë interesin e tyre për ofrimin e Shërbimeve. Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacion që tregon se ata kanë kualifikimet e kërkuara dhe përvojën përkatëse për të kryer shërbimet (siç përsëritet më sipër).

Kriteret e vlerësimit janë:

| Nr.          | Kriteri i vlerësimit                            | Pikët           |
|--------------|-------------------------------------------------|-----------------|
| 1.           | Kualifikimi i përgjithshëm i konsulentit        | 30 pikë         |
| 2.           | Përvojë specifike përkatëse në fushën e detyrës | 50 pikë         |
| 3.           | Gjuhë angleze                                   | 20 pikë         |
| <b>TOTAL</b> |                                                 | <b>100 pikë</b> |

Metoda e përzgjedhjes që do të aplikohet është Konsulenti Individual (IC) në përputhje me procedurat e përcaktuara Rregulloret e Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit IPF (prokurimi në financimin e projekteve të investimeve për mallrat, punët, shërbimet jokonsulente dhe konsulentë, korrik 2016, rishikuar në nëntor 2017 dhe në gusht 2018). Konsulenti do të jetë i angazhuar deri më 31 dhjetor 2024. Kontrata do të jetë e bazuar në ditë pune.

Informacione të mëtejshme mund të merren gjatë orarit të punës nga 08:00 deri në 16:30 (e hënë në të enjte) dhe nga ora 08:00 deri në 14:00 (të premten) në adresën e mëposhtme. Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (personalisht, me postë ose me *e-mail*) deri më **3 korrik 2023**.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale  
Adresa: Rruga e Kavajës Tiranë - Shqipëri  
Njësia e Koordinimit të Projektit (PCU)  
Projekti për Përmirësimin e Sistemit Shëndetësor (HSIP)  
Att: Blerina Dudushi  
e-mail: [hsip.dudushi@gmail.com](mailto:hsip.dudushi@gmail.com)

**Projekti për Përmirësimin e Sistemit Shëndetësor (HSIP) dhe financimi shtesë i HSIP-së**  
**Termet e referencës**  
**“Asistent zyre”**

**1. Prezantimi**

Së fundmi Qeveria e Shqipërisë ka marrë një kredi nga IBRD-ja në kuadër të projektit Projekti për Përmirësimin e Sistemit Shëndetësor për të përmirësuar aksesin dhe efikasitetin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor në Shqipëri. Objektivi i Zhvillimit të Projektit (PDO) është të kontribuojë në përmirësimin e efikasitetit të kujdesit në spitalet e përzgjedhura në Shqipëri, përmirësimin e menaxhimit të informacionit në sistemin shëndetësor dhe rritjen e aksesit financiar në shërbimet shëndetësore. Projekti i Përmirësimit të



Sistemit Shëndetësor të Shqipërisë (AHSIP) do të mbështesë:

a) reformimi i sektorit spitalor duke krijuar një kuadër ligjor dhe strukturë të shëndoshë menaxhuese për ofrimin e shërbimeve efikase, forcimin e menaxhimit dhe planifikimit të performancës, tejkalimin e kufizimeve operacionale në ofrimin e shërbimeve, mbështetjen e racionalizimit të rrjetit spitalor dhe forcimin e sistemit të referimit;

b) përmirësimin e monitorimit dhe menaxhimit të cilësisë dhe efikasitetit të shërbimit nëpërmjet krijimit të një sistemi informacioni të menaxhimit shëndetësor dhe të një sistemi të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore; dhe

c) reformimi i sistemeve të financimit të shëndetësisë dhe pagesave të ofruesve, përmirësimi i kapaciteteve të FSSH për blerje strategjike, forcimi i sistemeve për blerje/shpërndarje efikase të barnave dhe furnizimeve mjekësore dhe vlerësimi i opsioneve për të zgjeruar mbulimin e sigurimeve brenda hapësirës fiskale të disponueshme.

Projekti do të zbatohet për një periudhë pesëvjeçare. MSH-ja ka përgjegjësinë e përgjithshme për sektorin e shëndetësisë dhe mbikëqyrjen e politikave përkatëse. FSDKSH-ja do të jenë, gjithashtu, përgjegjëse ose do të kontribuojnë në zbatimin teknik të komponentëve ose nënkomponentëve të veçantë të Projektit. MSH-ja do të ketë përgjegjësi fiduciare për Projektin përmes Njesisë së Koordinimit të Projektit (NJKP) e cila do të krijohet brenda MSH-së.

Zëvendësministri i Shëndetësisë, si Koordinator i Projektit, do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen dhe koordinimin e përgjithshëm të projektit brenda MSH-së dhe nëpër institucionet kyçe (p.sh., FSSH, QKHN), siç ka qenë rasti në shumicën e projekteve të tjera. Grupet teknike të punës mund të krijohen për secilin nga tre komponentët kryesorë për të ofruar këshilla teknike dhe koordinim gjatë zbatimit. Projekti do të kërkojë mbikëqyrje të qartë të zbatimit, konsultime të rregullta me palët kryesore të interesuara, si dhe mekanizma vendimmarrës për të parandaluar dhe adresuar pengesat. Zëvendësministri do të jetë, gjithashtu, përgjegjës për marrjen e vendimeve për çështjet strategjike që mund të dalin gjatë zbatimit, në konsultim me ministrin e Shëndetësisë.

Brenda Ministrisë së Shëndetësisë do të krijohet një Njësi e Koordinimit të Projektit (NJKP) për të mbështetur zbatimin e projektit për Përmirësimin e Sistemit Shëndetësor në Shqipëri.

Zëvendësministri i MSH-së do të jetë koordinatori i përgjithshëm i projektit. PCU-ja, e kryesuar nga menaxheri i Projektit, do të përfshijë personelin kryesor përgjegjës për menaxhimin e besnikërisë dhe të mbrojtjes, dhe do të përfshijë një numër të kufizuar të personelit teknik (komponentët dhe koordinatorët e aktivitetit), të cilët do të koordinojnë aktivitetet e planifikuara, sipas secilit nga komponentët. Menaxheri i projektit do të ketë një nivel të përcaktuar përgjegjësie për çështjet operacionale. PCU-ja do të monitorojë dhe do të vlerësojë kuadrin e rezultateve të projektit dhe do të përfshijë stafin kryesor përgjegjës për menaxhimin teknik dhe fiduciar, të tillë si një menaxher projekti me kohë të plotë, dhe një koordinator IT, një inxhinier civil, një ekspert prokurimi, një ekspert të menaxhimit financiar dhe një asistent zyre.

## 2. Objektivi i detyrës

Objektivi i kësaj detyre është të ofrojë mbështetje administrative dhe logjistike, të ndihmojë në koordinimin e rrjedhës së informacionit dhe të gjurmojë orarin e dhënies së detyrave të ekipit të projektit.

## 3. Përshkrimi punës

- Mban procesverbalet e mbledhjeve dhe draftpërmbledhjet;

- Ndjek afatin kohor të zbatimit të detyrave të caktuara nga anëtarët e ekipit;

- Siguron mbështetje gjuhësore sipas nevojës, duke përfshirë përkthimin, interpretimin dhe redaktimin e tekstit;

- Ofron mbështetje logjistike dhe operacionale për menaxherin e projektit; ekspertin e prokurimit, ekspertin financiar dhe stafit tjetër të NJKP-së gjatë zbatimit të aktivitetëve të projektit;

- Përgatitja e modeleve të dokumenteve për përdorim të projektit dhe mbështetja e përgatitjes së prezantimeve;

- Mbështet aktivitetet e ekspertit të prokurimit të NJKP-së për hulumtimin e tregut;

- Të mirëmbajë arkivin e dokumenteve teknike të projektit, si në letër ashtu edhe në digital;

- Dokumenton aktivitetet e rregullta të projektit;

- Ndihmon specialistin e menaxhimit financiar për funksionimin e përditshëm financiar;



- Mbështet ekspert MF në futjen e të dhënave të sistemit;

- Kryen çdo detyrë tjetër të kërkuar nga Menaxheri i Projektit të NJKP-së dhe zëvendësministri.

#### 4. Kërkesat e raportimit

Asistenti i zyrës do të punojë nën mbikëqyrjen e përgjithshme të menaxherit të Projektit të PCU-së dhe zëvendësministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i cili do të lehtësojë aksesin e konsulentit në materialet e nevojshme dokumentare si dhe aksesin të palët kryesore të interesit në detyrë.

#### 5. Kualifikimet

- Diplomë *Bachelor* në ekonomi (financë, ekonomi, kontabilitet);

- Përvojë pune 3 vjet, mundësisht në projekte të mbështetura nga donatorët;

- Aftësi të shkëlqyera kompjuterike dhe njohuri të paketës *MS Office* (kryesisht *Word*, *Excel*, *PowerPoint*) dhe platformat e shkëmbimit të dokumenteve *online*;

- Aftësi të dëshmuara komunikuese dhe organizative;

- Aftësi për të punuar në një ekip, për të trajtuar njëkohësisht detyra të shumta komplekse, për t'u dhënë përparësi detyrave dhe për të përmbushur afate të ngushta;

- Njohja shumë e mirë e gjuhës shqipe dhe angleze (në të folur dhe të shkruar) është thelbësore.

#### 6. Kufizimet

Përveç kufizimeve standarde të konfliktit të interesit të specifikuar në kontratën e konsulencës, të gjitha materialet e krijuara sipas kësaj kontrate do të mbeten pronë e vetme e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Njësia e Koordinimit të Projektit HSIP. Ripërdorimi i materialeve do të kërkojë miratimin formal dhe me shkrim të Koordinimit të Projektit HSIP, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Konsulenti nuk do të ketë interes material në asnjë nga rezultatet e kësaj detyre. Me fillimin e detyrës, asistenti i zyrës do të përgatisë së bashku me Njësinë e Koordinimit të Projektit HSIP, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, një deklaratë konfidencialiteti që do ta detyrojë konsulentin të mos zbulojë çdo informacion të ndjeshëm për të cilin ai/ajo mund të ketë njohuri gjatë kryerjes së detyrës.

Kushtet e kësaj marrëveshjeje do të jenë në përputhje me ligjet përkatëse të privatësisë së Republikës së Shqipërisë.

#### 7. Afati kohor për detyrën

- Konsulenti do të angazhohet me kohë të plotë. Kompensimi do të paguhet në baza mujore dhe do të zbatohet sipas ligjit në fuqi.

- Konsulentit do t'i ofrohen mundësi për t'u zhvilluar profesionalisht duke ndjekur trajnimet dhe kurset përkatëse gjatë afatit të kontratës.

- Lloji i kontratës për këto detyra është Kontrata e bazuar në ditë pune.

### REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST (REOI) (CONSULTING SERVICES)

#### Individual Consultant

Tirana, 19<sup>th</sup> of June 2023

#### Additional Financing of Albania Health System Improvement Project (HSIP)

Loan No: 93060

Project ID Number: P144688

Assignment Title: Office Assistant

Reference No. AL-MH-330929-CS-INDV

The Government of Albania has received additional financing, in the amount of EUR 25 million for the Health System Improvement Project in Albania, a loan of International Bank for Reconstruction and Development (IBRD) to scale – up the activities of the parent project and ensure direct impact to the beneficiaries and further improvement of hospital care service provision in the country. The International Bank for Reconstruction and Development (“World Bank”) is acting as administrator of the amount provided. The Ministry of Health (MoHSP) herein after referred as “the Client” has overall responsibility for the Project, and the Project Coordination is responsible for the implementation of the Project through its Project Management Team (PMT). The objective of the Project is to contribute to the modernization of selected public hospital services and to support the reconstruction of selected medical facilities damaged by the 2019 earthquake. The Project consists of the following parts:



Part 1. Improving Hospitals Management and Infrastructure

Part 2. Improving Health Information Management / e-Health for Hospital Services:

Part 3: Monitoring, Evaluation and Project Management:

The additional financing will further support the hospital reform that derived by the Hospital Master Plan as a prerequisite for the rationalization of secondary level of health care in Albania and further improvement of efficiency and quality enhancement of hospitals. Under the Component 3 of the HSIP project, the MOHSP will hire an Office Assistant that will provide administrative and logistical support, help coordinate the information flow and track the project team task delivery schedule.

**The Ministry of Health and Social protection is seeking for an individual consultant to conduct this assignment which fulfill the following criteria:**

- Bachelor's degree in economy (finance, economics, accounting).
- Work experience of 3 years, preferably in donor-supported projects;
- Excellent computer skills and knowledge of the MS Office suite (primarily Word, Excel, PowerPoint), and online document-sharing platforms;
- Proven communication and organizational skill;
- Ability to work in a team, handle multiple complex tasks concurrently, able to prioritize tasks and meet tight deadlines.
- Very good Command of Albanian and English language (spoken and written) is essential.

The consultant who will be selected (after fulfilling the minimum qualification/experience requirements above) as highest ranked based on the evaluation/shortlistign criteria below, will be invited for contract negotiations

The Ministry of Health and Social Protection, through Project Coordination Unit (PCU) now invites eligible individual local consultants ("Consultants") to indicate their interest in providing the Services. Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services (as described above). The evaluation criteria are:

| No.          | Evaluation Criterion                                        | Points            |
|--------------|-------------------------------------------------------------|-------------------|
| 1.           | General Qualification of the consultant                     | 30 points         |
| 2.           | Relevant Specific Experience in the field of the assignment | 50 points         |
| 3.           | English language                                            | 20 points         |
| <b>TOTAL</b> |                                                             | <b>100 points</b> |

The selection method to be applied is Individual Consultant (IC) in accordance with the procedures set out the World Bank's Procurement Regulations for IPF Borrowers (procurement in investment project financing Goods, Works, Non-Consulting and Consulting Services July 2016 Revised November 2017 and August 2018). The consultant shall be engaged until 31st of December 2024. The contract will be Time Based

Further information can be obtained at the address below during office hours 08:00 to 16:30 (Monday to Thursday) and 08:00 to 14:00 on Friday In the address below). Expressions of interest must be delivered in a written form to the address below (in person, or by mail, or by e-mail) by **03<sup>rd</sup> of July 2023**.

Ministry of Health and Social Protection  
 Address: Rruga e Kavajës, Tirana - Albania  
 Project Coordination Unit (PCU)  
 Health System Improvement Project (HSIP)  
 Att: Blerina Dudushi  
 e-mail: [hsip.dudushi@gmail.com](mailto:hsip.dudushi@gmail.com)

## **Health System Improvement Project (HSIP) and HSIP Additional Financing**

### **Terms of Reference "Office Assistant"**

#### **1. Introduction**

Recently the Government of Albania has received a loan from IBRD under the project Health System Improvements Project to improve access and efficiency of health care services in Albania. The Project Development Objective (PDO) is to contribute to improving the efficiency of care in selected hospitals in Albania, improving the management of information in the health system, and increasing financial access to health services. The Albania Health System Improvements Project (AHSIP) will support:

- a) reforming the hospital sector by creating a sound legal framework and management structure



for efficient service provision, strengthening performance management and planning, overcoming operational constraints in service delivery, supporting rationalization of the hospital network, and strengthening the referral system;

b) improving monitoring and management of service quality and efficiency through the establishment of a health management information system and of a medical equipment management and maintenance system; and

c) reforming the health financing and provider payment systems, improving capacity of the HIF for strategic purchasing, strengthening systems for efficient purchasing/distribution of pharmaceuticals and medical supplies, and assessing options to expand insurance coverage within the available fiscal space.

The Project will be implemented over a period of five years. The MoH has overarching responsibility for the health sector and related policy oversight. The Health Insurance Fund (HIF) and the National Health Information Center (NHIC) will also be responsible for, or will contribute to, technical implementation of specific Project components or sub-components. The MoH will have fiduciary responsibility for the Project through a Project Coordination Unit (PCU) which will be established within MoH.

The Deputy Minister of Health, as Project Coordinator, will be responsible for the overall Project oversight and coordination within the MoH and across key institutions (e.g., HIF, NHIC) as has been the case in most other projects. Technical working groups may be established for each of the three main components to provide technical advice and coordination during implementation. The Project will require clear implementation oversight, regular consultation with key stakeholders as well as decision making mechanisms to prevent and address bottlenecks. The Deputy Minister will also be responsible for taking decisions on strategic issues that may arise during implementation, in consultation with the Minister of Health

A Project Coordination Unit (PCU) will be established within the MoH to support implementation of the Albania Health System Improvement project.

The Deputy Minister of MoH will be the overall Project Coordinator. The PCU, headed by the

Project Manager, will include core staff responsible for fiduciary and safeguard management, and will include a limited number of technical staff (component and activity coordinators) who will coordinate activities planned under each of the components. The Project Manager will have a defined level of responsibility for operational issues. The PCU will monitor and evaluate the Project results framework and will include core staff responsible for technical and fiduciary management, such as a full-time Project Manager, and IT coordinator, a Civil engineer, a Procurement Expert, a Financial Management Expert and an Office Assistant.

## **2. Objective of the assignment**

The objective of this assignment is to provide administrative and logistical support, help coordinate the information flow and track the project team task delivery schedule.

## **3. Scope of Work**

- Keep meeting minutes and draft summaries;
- Follow the implementation timeline of the team members assigned tasks;
- Provide language support as needed, including translation, interpretation and text editing;
- Offer logistical and operational support to the Project Manager, Procurement Expert, Financial Expert and other staff of the PCU, during project activities' implementation;
- Prepare document templates for project use, and support preparation of presentations;
- Support the PCU procurement expert's market research activities;
- Maintain the project technical documents archive, both paper and digital;
- Document project regular activities;
- Assisting the financial management specialist for daily financial operation.
- Support FM expert in system data entry
- Perform any other duties requested by the PCU Project Manager and Deputy minister

## **4. Reporting Requirements**

The Office Assistant shall work under the general supervision of the PCU Project Manager and Deputy minister of Health and Social protection, who will facilitate the Consultant's access to the necessary documentary materials as well as access to the key stakeholders to the assignment.

**5. Qualifications**

- Bachelor's degree in economy (finance, economics, accounting).
- Work experience of 3 years, preferably in donor-supported projects;
- Excellent computer skills and knowledge of the MS Office suite (primarily Word, Excel, PowerPoint), and online document-sharing platforms;
- Proven communication and organizational skill;
- Ability to work in a team, handle multiple complex tasks concurrently, able to prioritize tasks and meet tight deadlines.
- Very good Command of Albanian and English language (spoken and written) is essential.

**6. Restrictions**

In addition to the standard conflict of interest restrictions specified in the consulting Contract, all materials created under this Contract will remain the sole property of the Ministry of Health and Social Protection, HSIP Project Coordination Unit. Re-use of the materials will require the formal, written approval of the, HSIP Project Coordination, Ministry of Health and Social Protection.

The Consultant shall have no material interest in any of the outputs of this assignment. On the commencement of the assignment, the Office Assistant will jointly prepare with the HSIP Project Coordination Unit, Ministry of Health and Social protection, a Statement of Confidentiality that will bind the Consultant to nondisclosure of any sensitive information that he/she may become knowledgeable of in the course of the assignment.

The terms of this agreement shall be made consistent with the relevant privacy laws of the Republic of Albania.

**7. Time-frame for the assignment**

- The Consultant shall be engaged on full-time basis. The remuneration will be paid on a monthly basis and implemented according to Applicable Law.
- The Consultant will be offered opportunities to develop professionally by attending relevant training events and courses during the term of the contract.
- The type of contract for these assignments is Time Based Contract.



Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.  
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik  
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Tiranë, 2023